
بسم الله الرحمن الرحيم
شمس الشموس

40 HADITHE NGA IMAM RIZAI

(Paqja qoftë mbi të!)

Tiranë, 2021

Titulli: ***40 hadithe nga Imam RIZAI***
(Paqja qoftë mbi të!)

I përzgjodhi dhe i përktheu: **Elisabeta Feza**

Recensent: **Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**
Korrektoi: **Vjollca Karaj**
Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie Feza**
Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: Shoqata Flladi – Tiranë, 2021

IMAM RIZAI

(Paqja qoftë mbi të!)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Falënderimet i takojnë Allahut, të Vetëm e të Pashoq! Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër, mbi shokët e tij të zgjedhur dhe mbi të gjithë ata besimtarë e besimtare që e ndjekin rrugën e tyre, me përkushtim e sinqeritet, deri në Ditën e fundit të kësaj jete.

Të dashur vëllezër dhe motra!

Es selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!

Në këto pak rreshta do të flasim për një nga imamët e Ehli Bejtit të Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*, Imam Ali ibn Musa Rizain *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Ai është Aliu, i biri i Musait, i biri i Xhaferrit, i biri i Muhamedit, i biri i Aliut, i biri i Hysenit, i biri i Aliut, i biri i Ebu Talibit *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Lindja e tij

Imam Ali Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka lindur në Medinen e ndritur, në vitin 153 hixhri.

Imamati i tij

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* e filloi udhëheqjen (imamatin) e tij pas vdekjes së babait, Imam Kadhimit *(Paqja qoftë mbi të!)*, në vitin 183 hixhri.

Prej punëve më të rëndësishme të Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)*ishin:

1- Sqarimi i besimit islam dhe pastrimi i tij prej shmangieve që u përhapën në fillim të pushtetit abasit.

2- Mësimdhënia e rregullave dhe e dispozitave të fesë, si dhe përhapja e haditheve të Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

3- Sqarimi dhe theksimi se Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* ishte prijës i besimtarëve, menjëherë pas Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* dhe ai e meritonte plotësisht këtë pozitë.





Vilajeti i Ahdit

Në kohën e imamatit të Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)*, Me'muni, udhëheqësi abasit i asaj kohe, zgjodhi imam Veliju Ahdin. Këtë e bëri për shkak të faktorëve të mëposhtëm politikë:

1- Xhaxhallarët e Me'munit anonin kah vëllait të tij, Eminit. Me këtë veprim kërkonte t'i tërhiqte ata kah vetes, nga frika se mos pushteti kalonte nga abasitët tek alevitët.

2- Përpjekja e Me'munit për të shtypur e për të shkrirë lëvizjet politike që ftonin në rrugën e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe këto lëvizje të mos përfitonin nga

hendeku i mosmarrëveshjes mes Me'munit dhe vëllait të tij, Eminit dhe nga përçarja e abasitëve për pushtet.

3- Përpjekja e Me'munit që pasuesit e Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)* t'i tërhiqte nga ana e tij, për të shtuar fuqinë e tij kundër përkrahësve të vëllait të tij, Eminit.

Kjo përpjekje e Me'munit, përveç Vilajetit të Ahdit, bazohej edhe në:

1- Pohimin e Me'munit se imamët e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)* e meritonin më shumë se abasitët udhëheqjen *(kalifatin)*. Këtë pohim e ka shprehur qartë jo vetëm në diskutimet dhe dialogët e tij, por dhe në tekstin e Vilajetit të Ahdit.

2- Prodhimin e monedhës nga Me'muni me emrin e Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)*.

3- Mbikëqyrjen e Imam Rizait drejtpërsëdrejti prej tij, me qëllim që Imami të mos bënte asnjë aktivitet politik kundër abasitëve.

Vdekja e tij

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* vdiq në qytetin Tus, krahinë e Horasanit (Mashhadi i sotëm- Iran), në vitin 203 hixhri.

Prej lutjeve të tij

"O Zoti Im! Më dhuro udhëzim dhe më forco në të! Më mblidh te njerëzit e udhëzuar e të sigurt nga çdo frikë e hidhërim! Vërtet, Ti je Pronari i devotshmërisë, i faljes dhe i mëshirës!"

Shkurtimisht rreth personalitetit të Imamit Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)*

Imam Ali ibn Musa Riza (er Rida) *(Paqja qoftë mbi të!)* është prej Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*; është imami i myslimanëve, udhërrëfyes dhe reformues. Jeta e tij ka qenë fener ndriçimi për

udhëzuesit dhe tregues për ata që ndjekin rrugën e besimit të vërtetë. Ka qenë shembull në moral dhe në vijën e drejtë.

Këtu do të përmendim shkurtimisht disa cilësi të larta morale të Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)*.

1– Rexha ibn Ebu Dahhaku, i cili shoqëroi Imamin gjatë udhëtimit të tij nga Medina për në Merva, na përshkruan besimin dhe ibadetin (adhurimin) e Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)* me këto fjalë: "Unë isha me atë nga Medina deri në Merva. Betohem në Allah, se unë nuk kam parë njeri më besimtar se ai, as përkujtues të Zotit më tepër se ai në kohën e tij, as frikësues ndaj Allahut të Madhëruar sa

ishte ai. Ai e falte sabahun dhe ulej në vendin e faljes, duke e madhëruar Allahun e Madhëruar, duke e falënderuar e duke e lartësuar Atë. Ai dërgonte salavate për Profetin Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!),* deri sa lindte dielli. Më pas binte në sexhde dhe rrinte për një kohë të gjatë. Më pas shkonte te njerëzit. U fliste dhe i këshillonte ata deri sa vinte vakti i ylesë". ("Ujun Akhbaru Err Rrida", vëll. 2, f. 180.)

2– Ibrahim ibn Abas Es Suliji, për cilësitë e Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)*, ka thënë: "Ai flinte pak natën. Në të shumtën e netëve rrinte zgjuar deri në sabah. Agjëronte shumë. Atij nuk i kalonte agjërimi i tri ditëve në çdo muaj dhe

thoshte se ky është agjërimi i epokës. Jepte sadaka dhe ndihmonte mjaft në fshehtësi. Këtë e bënte më tepër në netët e errëta. Kush thotë se ka parë të ngjashëm me Imam Rizain *(Paqja qoftë mbi të!)* në këtë veprim, mos e beso". ("Ujun Akhbaru Err Rida", vëll. 2, f. 184.)

3– Ahmed Murafikiji thotë: "Unë isha me Rizain *(Paqja qoftë mbi të!)* në udhëtimin e tij për në Horasan (Iran). Një ditë shtroi një gosti dhe ftoi të gjithë dashamirësit e tij. Unë i thashë: 'U bëfsha kurban për ty, sikur ta ndaje gostinë për ata'. Ai tha: 'Pusho, Allahu i Madhëruar është Një, umeti është një, babai është një dhe shpërblimi është me punë'". ("Biharul Anuar", vëll. 49. f. 101.)

4– Jasir Hadimi dhe Nadir Hadimi kanë thënë se Ebu Hasani *(Paqja qoftë mbi të!)* u tha: "Nëse unë vij dhe ju jeni duke ngrënë, mos u çoni, derisa të mbaroni së ngrëni". ("Biharul Anuar", vëll. 49, f. 159.)

5- El Visha ka transmetuar: "Në ditë unë hyra tek Ali ibn Musa Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në dorë kishte një ibrik, të cilin e kishte mbushur me ujë, për të marrë abdes.

Unë u afrova që t'i hedh ujë, por ai nuk pranoi dhe më tha: 'Jo o Hasan!'

- Përse më ndalon t'u hedh ujë duarve të tua? Nuk të pëlqen të shpërblehem?, - i thashë unë.

- Të shpërblehesh ti dhe të fajësohem unë?, - tha ai.

- Si ka mundësi?, - e pyeta.

- A nuk e ke dëgjuar thënien e Allahut të Madhëruar: **"Kush shpreson të takohet me Zotin e tij, të punojë punë të mira dhe mos më bëjë shok në ibadedet e tij."?** Unë po marr abdes për namaz dhe ky është ibadet. Unë nuk e pëlqej që në këtë ibadet, të marrë pjesë tjetër kush me mua, - m'u përgjigj ai". ("El Kafij", vëll. 3, f. 69.)

6- Me'muni i ka thënë Fadl ibn Sehlit dhe vëllait të tij: "Unë nuk njoh njeri më të virtytshëm në sipërfaqen e tokës se ky burrë - e kishte fjalën për Imam Ali ibn Musa Rizain". ("El Irshad", vëll. 2, f. 261;

"A'lamul Uera bi A'lamuil Huda", vëll. 2, f. 72; "Mukatilu Talibijn", f. 375; "El Fusulul Muhimmeh", vëll. 2, f. 1005.)

Me rastin e ditëlindjes së Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!),* shoqata "Flladi" ka përgatitur një libërth me titull: **"40 hadithe nga Imam Rizai"**. Hadithet janë përkthyer nga gjuha perse, nga e nderuara Elizabeta Feza. Hadithet janë marrë nga libri **"Ujunu Akhabru Err Rrida",** i autorit **Esh Shejkh Sadukut** *(Allahu e mëshiroftë!)*.

Shoqata "Flladi" falënderon të gjithë bashkëpunëtorët e palodhur që kontribuuan në përgatitjen e këtij libërthi. Shpresojmë që besimtarët myslimanë të

përfitojnë sa më shumë prej thënieve dhe porosive të të dashurve të Allahut!

Allahu na mundësoftë të jemi në rrugën e Tij dhe në rrugën e të dashurve të Tij, të cilët sakrifikuan gjithçka për udhëzimin e njerëzve dhe na bashkoftë me ata në Jetën Tjetër!

Shoqata "Flladi"

40 HADITHE NGA IMAM RIZAI

(Paqja qoftë mbi të!)

1- Tri cilësitë më të mira të besimtarit

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Besimtari, nuk është besimtar i vërtetë, nëse nuk ka tri cilësi: tradhtë nga Zoti i tij; tradhtë nga Profeti i tij; tradhtë nga Prijësi (Imami) i tij. Për sa i përket tradhtës së Zotit të tij, është të mbulojë sekretin e vet; tradhta e Profetit të tij është, që të jetë tolerant dhe i butë me njerëzit dhe tradhta e Prijësit (Imamit) të tij është, që të jetë i durueshëm në kohë varfërie dhe ankthi".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): لا يَكُونُ الْمُؤْمِنُ مُؤْمِنًا حَتّى تَكُونَ فيهِ ثَلاثُ خِصال:1. سُنَّةٌ مِنْ رَبِّهِ. 2. وَ سُنَّةٌ مِنْ نَبِيِّهِ. 3. وَ سُنَّةٌ مِنْ وَلِيِّهِ. فَأَمَّا السُّنَّةُ مِنْ رَبِّهِ فَكِتْمانُ سِرِّهِ. وَ أَمَّا السُّنَّةُ مِنْ نَبِيِّهِ فَمُداراةُ النّاسِ. وَ أَمَّا السُّنَّةُ مِنْ وَلِيِّهِ فَالصَّبْرُ فِي الْبَأْساءِ وَ الضَّرّاءِ.

مؤمن، مؤمن واقعی نیست، مگر آن که سه خصلت در او باشد:سنّتی از پروردگارش و سنّتی از پیامبرش و سنّتی از امامش. امّا سنّت پروردگارش، پوشاندن راز خود است،امّا سنّت پیغمبرش، مدارا و نرم رفتاری با مردم است،امّا سنّت امامش، صبر کردن در زمان تنگدستی و پریشان حالی است.

2- Shpërblimi i veprave të mira në fshehtësi dhe dënimi i shfaqjes së veprave të këqija

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Shpërblimi i atij që fsheh një vepër të mirë, është i barabartë me shtatëdhjetë mirësi; përhapësi i një vepre të keqe është i poshtëruar dhe për atë që fsheh një vepër të keqe, ka falje për të".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): أَلْمُسْتَتِرُ بِالْحَسَنَةِ يَعْدِلُ سَبْعِينَ حَسَنَةً، وَ الْمُذيعُ بِالسَّيِّئَةِ مَخْذُولٌ، وَالْمُسْتَتِرُ بِالسَّيِّئَةِ مَغْفُورٌ لَهُ.

پنهان کننده کار نیك [پاداشش] برابر هفتاد حسنه است، و آشکارکننده کار بد سرافکنده است، و پنهان کننده کار بد آمرزیده است.

3- Pastërtia

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Pastërtia është prej moralit të Profetëve".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): مِنْ أَخْلاقِ الأَنْبياءِ التَّنَظُّفُ.

از اخلاق پیامبران، نظافت و پاکیزگی است.

4- Besniku dhe i besueshmi

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Besniku nuk të tradhton ty, por ti e hamendësove tradhtarin të besueshëm".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): لم يخنك الأمين، ولكن ائتمنت الخائن

امین به تو خیانت نکرده [و نمکند] و لیکن [تو] خائن را امین تصوّر نموده ای.

5- Pozita e vëllait të madh

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Vëllai i madh është në pozitën e babait".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): أَلاَخُ الاَكْبَرُ بِمَنْزِلَةِ الاَبِ.

برادر بزرگتر به منزله پدر است.

6- Miku dhe armiku i çdo kujt

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Miku i gjithsecilit është intelekti i tij dhe armiku është injoranca e tij".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): صَديقُ كُلِّ امْرِءٍ عَقْلُهُ وَ عَدُوُّهُ جَهْلُهُ.

دوست هر کس عقل او، و دشمنش جهل اوست.

7- Të thirrurit me respekt

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Nëse përmendni dikë që është i pranishëm, përmendeni me pseudonimin e tij, nëse ai mungon, kur e përmendni, thoni emrin e tij".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): إذا ذَكَرْتَ الرَّجُلَ وَهُوَ حاضِرٌ فَكَنِّهِ، وَ إذا كَانَ غائِباً فَسَمِّه.

چون شخص حاضری را نام بری [برای احترام] کنیه او را بگو و اگر غائب باشد نامش را بگو.





8- E keqja e thashethemeve

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Me të vërtetë, Allahu i urren thashethemet, humbjen e pasurisë (aty ku nuk duhet harxhuar) dhe bërjen e shumë pyetjeve (të kota)".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): إنَّ اللهَ يُبْغِضُ الْقيلَ وَ الْقالَ وَ إضاعَةَ الْمالِ وَ كَثْرَةَ السُّؤالِ.

به درستی که خداوند، داد و فریاد و تلف کردن مال و پُرخواهشی را دشمن می دارد.

9- Dhjetë cilësi të të mençurit

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Intelekti i një myslimani nuk është i plotë, vetëm nëse në të gjenden dhjetë cilësi:*

1- Shpresa e mirë prej tij.

2- Të jesh i sigurt nga e keqja e tij.

3- Të mirën e vogël të tjerëve ta shohë si një të mirë të madhe.

4- Të mirën e tij të madhe ta shohë si një të mirë të vogël.

5- Të mos lodhet, kur i kërkojnë ndihmë.

6- Të mos lodhet duke kërkuar dituri në jetën e tij.

7- Varfëria, për hir të Allahut, të jetë për atë më e dashur se pasuria.

8- Poshtërimi, për hir të Allahut, të jetë më i dashur për atë se sa nderimi i armikut të tij.

9- Të mbetet anonim (i panjohur), të jetë më i dëshirueshëm për atë se sa fama.

10- Pastaj ai (Pagja qoftë mbi të!) tha: "E dhjeta, cila është e dhjeta?"

Atij i thanë: "Çfarë është ajo?"

Ai tha: "Kur shikon ndonjë tjetër, të thotë se ai është më i mirë dhe më i devotshëm se unë".

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): لا يَتِمُّ عَقْلُ امْرِءٍ مُسْلِمٍ حَتّى تَكُونَ فيهِ عَشْرُ خِصال: أَلْخَيْرُ مِنْهُ مَأمُولٌ. وَ الشَّرُّ مِنْهُ مَأْمُونٌ. يَسْتَكْثِرُ قَليلَ الْخَيْرِ مِنْ غَيْرِهِ، وَ يَسْتَقِلُّ كَثيرَ الْخَيْرِ مِنْ نَفْسِهِ. لا يَسْأَمُ مِنْ طَلَبِ الْحَوائِجِ إِلَيْهِ، وَ لا يَمَلُّ مِنْ طَلَبِ الْعِلْمِ طُولَ دَهْرِهِ. أَلْفَقْرُ فِي اللهِ أَحَبُّ إِلَيْهِ مِنَ الْغِنى. وَ الذُّلُّ فِي اللهِ أَحَبُّ إِلَيْهِ مِنَ الْعِزِّ فى عَدُوِّهِ. وَ الْخُمُولُ أَشْهى إِلَيْهِ مِنَ الشُّهْرَةِ. ثُمَّ قالَ (عليه السلام): أَلْعاشِرَةُ وَ مَا الْعاشِرَةُ؟ قيلَ لَهُ: ما هِيَ؟ قالَ (عليه السلام): لا يَرى أَحَدًا إِلاّ قالَ: هُوَ خَيْرٌ مِنّي وَ أَتْقى.

عقل شخص مسلمان تمام نیست، مگر این که ده خصلت را دارا باشد:1. از او امید خیر باشد. 2. از بدی او در امان باشند. 3. خیر اندك دیگری

را بسیار شمارد. 4. خیر بسیار خود را اندك شمارد. 5. هر چه حاجت از او خواهند دلتنگ نشود. 6. در عمر خود از دانش طلبی خسته نشود. 7. فقر در راه خدایش از توانگری محبوبتر باشد. 8. خواری در راه خدایش از عزّت با دشمنش محبوبتر باشد. 9. گمنامی را از پرنامی خواهانتر باشد. 10. سپس فرمود: دهمی چیست و چیست دهمی؟ به او گفته شد: چیست؟ فرمود: احدی را ننگرد جز این که بگوید او از من بهتر و پرهیزکارتر است.

10- Shenja e më të ulëtit

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* u pyet: *"Kush është më i ulët?" Ai tha: "Ai që ka dicka që e pengon të kujtojë Allahun".*

سُئِلَ الرِّضا (عليه السلام) عَنِ السِّفْلَةِ فَقالَ (عليه السلام):مَنْ كانَ لَهُ شَيْءٌ يُلْهيهِ عَنِ اللهِ.

از امام رضا (عليه السلام) سؤال شد: سفله كيست؟فرمود: آن كه چيزى دارد كه از [ياد] خدا بازش دارد.

11- Besimi, devotshmëria dhe bindja

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Besimi (imani) është një shkallë më lart se Islami; devotshmëria është një shkallë më lart se besimi dhe nuk u është dhënë bijve të Ademit asgjë më e lartë se sa bindja".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): إنَّ الإيمانَ أَفْضَلُ مِنَ الأِسْلامِ بِدَرَجَه، وَ التَّقْوى أَفْضَلُ مِنَ الإيمانِ بِدَرَجَة وَ لَمْ يُعطَ بَنُو آدَمَ أَفْضَلَ مِنَ الْيَقينِ.

ايمان يك درجه بالاتر از اسلام است، و تقوا يك درجه بالاتر از ايمان است و به فرزند آدم چيزى بالاتر از يقين داده نشده است.

12- Mikpritja në dasma

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Prej traditës së të ushqyerit, është ushqimi në dasma".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): مِنَ السُّنَّةِ إِطْعامُ الطَّعامِ عِنْدَ التَّزْويجِ.

اطعام و میهمانی کردن برای ازدواج از سنّت است.

13- Përkushtimi ndaj të afërmve me gjënë më të paktë

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Ruaje lidhjen tënde farefisnore, qoftë edhe me një gllënjkë uji. Lidhja më e mirë e farefisnisë është që të mos u bësh keq atyre (të afërmve)".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): صِلْ رَحِمَكَ وَ لَوْ بِشَرْبَة مِنْ ماء، وَ أَفْضَلُ ما تُوصَلُ بِهِ الرَّحِمُ كَفُّ الأَذى عَنْه.

پیوند خویشاوندی را برقرار کنید گرچه با جرعه آبی باشد، و بهترین پیوند خویشاوندی، خودداری از آزار خویشاوندان است.

14- Arma e të Dërguarve *(Profetëve)*

Transmetohet se Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* gjithmonë u thoshte shokëve të tij: *"Ju këshilloj armën e Profetëve". Ata e pyetën: "Cila është arma e Profetëve?" Ai tha: "Lutja (duaja)".*

عَنِ الرِّضا (عليه السلام) أَنَّهُ كانَ يَقُولُ لأَصْحابِهِ: عَلَيْكُمْ بِسِلاحِ الأَنْبِياءِ، فَقيلَ: وَ ما سِلاحُ الأَنْبِياءِ؟ قالَ: أَلدُّعاءُ.

حضرت رضا (عليه السلام) همیشه به اصحاب خود می فرمود: بر شما باد به اسلحه پیامبران، گفته شد: اسلحه پیامبران چیست؟ فرمود: دعا.

15- Shenjat e të kuptuarit

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Prej shenjave të të kuptuarit të fesë, është durimi dhe dija. Heshtja është një derë prej dyerve të urtësisë. Sigurisht, heshtja sjell dashurinë dhe është tregues i çdo të mire".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): إنَّ مِنْ عَلاماتِ الْفِقْهِ: أَلْحِلْمُ وَ الْعِلْمُ، وَ الصَّمْتُ بابٌ مِنْ أَبْوابِ الْحِكْمَةِ إنَّ الصَّمْتَ يَكْسِبُ الَمحَبَّةَ، إنَّهُ دَليلٌ عَلى كُلِّ خَيْر.

از نشانه های دین فهمی، حلم و علم است، و خاموشی دری از درهای حکمت است. خاموشی و سکوت، دوستآور و راهنمای هر کار خیری است.

16- Izolimi dhe heshtja

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Do të vijë një kohë për njerëzit, ku shëndeti do të jetë në dhjetë pjesë, nëntë prej të cilave do të jenë te largimi nga njerëzit (për gjëra të kota) dhe një pjesë do të jetë te heshtja".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): يَأْتى عَلَى النّاسِ زَمانٌ تَكُونُ الْعافِيَةُ فيهِ عَشَرَةَ أَجْزاء: تِسْعَةٌ مِنْها فى إِعْتِزالِ النّاسِ وَ واحِدٌ فِى الصَّمْتِ.

زمانی بر مردم خواهد آمد که در آن عافیت ده جزء است که نُه جزء آن در کناره گیری از مردم و یك جزء آن در خاموشی است.

17- E vërteta e të mbështeturit te Allahu

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* u pyet: *"Cili është caku i mbështetjes (te Allahu)?"* Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Që të mos frikësohesh nga askush tjetër, përveç Allahut".*

سُئِلَ الرِّضا (عليه السلام): عَنْ حَدِّ التَّوَكُّلِ؟ فَقالَ (عليه السلام): أَنْ لا تَخافَ أحَدًا إلّااللهَ.

از امام رضا (عليه السلام) از حقيقت توكّل سؤال شد.

فرمود: اين كه جز خدا از كسى نترسى.

18- Më i keqi i njerëzve

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Më i keqi i njerëzve është ai që ndalon shoqërimin e tij (me të tjerët), ha vetëm dhe rreh shërbyesit e tij".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): إنَّ شَرَّ النّاسِ مَنْ مَنَعَ رِفْدَهُ وَ أَكَلَ وَحْدَهُ وَ جَلَدَ عَبْدَهُ.

به راستی که بدترین مردم کسی است که یاری اش را [از مردم] باز دارد و تنها بخورد و زیردستش را بزند.





19- Nuk ka besnikëri për sundimtarin

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Nuk ka rehati për kopracin, nuk ka kënaqësi për smirakun, nuk ka besnikëri për sundimtarin dhe nuk ka burrëri për gënjeshtarin".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): لَيْسَ لِبَخيل راحَةٌ، وَ لا لِحَسُود لَذَّةٌ، وَ لا لِمُلُوك وَفاءٌ وَ لا لِكَذُوب مُرُوَّةٌ.

بخیل را آسایشی نیست و حسود را خوشی و لذّتی نیست و زمامدار را وفایی نیست و دروغگو را مروّت و مردانگی نیست.

20- Puthja e dorës

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Asnjë njeri të mos ia puthë dorën një tjetri, sepse puthja e dorës është sikur të falësh namaz për të".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): لا يُقَبِّلُ الرَّجُلُ يَدَ الرَّجُلِ، فَإِنَّ قُبْلَةَ يَدِهِ كَالصَّلاةِ لَهُ.

کسی دست کسی را نبوسد، زیرا بوسیدن دست او مانند نماز خواندن برای اوست.





21-Të menduarit mirë për Allahun

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Mendo mirë për Allahun, sepse kush mendon mirë për Allahun, edhe Ai mendon mirë për të. Kush është i kënaqur me furnizimin e paktë, do t'i pranohet puna e paktë e tij. Kush është i kënaqur nga ushqimi i paktë hallall, atij do t'i lehtësohet ngarkesa, do t'i begatohet familja dhe Allahu do ta bëjë të kuptueshëm për këtë jetë dhe për shërimin e saj dhe do ta nxjerrë atë prej saj të shëndetshëm për në vendbanimin e pages (Xheneti)".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): أَحْسِنِ الظَّنَّ بِاللهِ، فَإِنَّ مَنْ حَسُنَ ظَنُّهُ بِاللهِ كانَ عِنْدَ ظَنِّهِ وَ مَنْ رَضِيَ بِالْقَليلِ مِنَ الرِّزْقِ قُبِلَ مِنْهُ الْيَسيرُ مِنَ الْعَمَلِ. وَ مَنْ رَضِيَ بِالْيَسيرِ مِنَ الْحَلالِ خَفَّتْ مَؤُونَتُهُ وَ نُعِّمَ أَهْلُهُ وَ بَصَّرَهُ اللهُ دارَ الدُّنْيا وَ دَواءَها وَ أَخْرَجَهُ مِنْها سالِمًا إِلى دارِ السَّلامِ.

به خداوند خوشبين باش، زيرا هر كه به خدا خوشبين باشد، خدا با گمانِ خوشِ او همراه است، و هر كه به رزق و روزى اندك خشنودباشد، خداوند به كردار اندك او خشنود باشد، و هر كه به اندك از روزى حلال خشنود باشد، بارش سبك و خانواده اش در نعمت باشد و خداوند او را به درد دنيا و دوايش بينا سازد و او را از دنيا به سلامت به دارالسّلامِ بهشت رساند.





22- Shtyllat e besimit

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Besimi ka katër shtylla:*

1- Mbështetja te Allahu.

2- Kënaqësia me caktimin e Allahut.

3- Dorëzimi para urdhrit të Allahut.

4- Lënia e punëve (në dorë të) Allahut".

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): أَلْأيمانُ أَرْبَعَةُ أَرْكان: أَلتَّوَكُّلُ عَلَى اللهِ، وَ الرِّضا بِقَضاءِ اللهِ وَ التَّسْليمُ لِأَمْرِاللهِ، وَ التَّفْويضُ إِلَى اللهِ.

ایمان چهار رکن دارد:

1. توکّل بر خدا

2. رضا به قضای خدا

3. تسلیم به امر خدا

4 واگذاشتن کار به خدا.

23- Robtë më të mirë të Allahut

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* u pyet se cilët janë robtë më të mirë. Ai *(Paqja qoftë mbi të!)* tha: *"Janë ata që, kur bëjnë mirë, gëzohen; kur bëjnë keq, kërkojnë falje; sa herë u jepet falënderojnë; kur u bie ndonjë e keqe, bëjnë durim dhe sa herë zemërohen, falin".*

سُئِلَ عَلَيْهِ السَّلامُ عَنْ خِيارِ الْعبادِ؟ فَقالَ (عليه السلام):أَلَّذينَ إذا أَحْسَنُوا إِسْتَبْشَرُوا، وَ إذا أَساؤُوا إِسْتَغْفَرُوا وَ إذا أُعْطُوا شَكَرُوا، وَ إذا أُبْتِلُوا صَبَرُوا، وَ إذا غَضِبُوا عَفَوْ.

از امام رضا (علیه السلام) درباره بهترین بندگان سؤال شد. فرمود: آنان که هر گاه نیکی کنند خوشحال شوند، و هرگاه بدی کنند آمرزش خواهند، و هر گاه عطا شوند شکر گزارند و هر گاه بلا بینند صبر کنند، و هر گاه خشم کنند درگذرند.

24- Poshtërimi i të varfërve

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Kush takon një mysliman të varfër dhe e përshëndet atë ndryshe nga ajo që përshëndet të pasurit, në Ditën e Gjykimit do të përballet me Allahun, që do të jetë i zemëruar ndaj tij".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): مَنْ لَقِيَ فَقيرًا مُسْلِمًا فَسَلَّمَ عَلَيْهِ خِلافَ سَلامِهِ عَلَى الأَغْنِياءِ لَقَى اللهُ عَزَّوَجَلَّ يَوْمَ الْقِيمَةِ وَ هُوَ عَلَيْهِ غَضْبانُ.

کسی که فقیر مسلمانی را ملاقات نماید و بر خلاف سلام کردنش بر اغنیا بر او سلام کند، در روز قیامت در حالی خدا را ملاقات نماید که بر او خشمگین باشد.

25- Lumturia në dynja

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* u pyet rreth gëzimit në dynja. Ai tha: *"Shtëpia e gjerë dhe miqtë e shumtë".*

سُئِلَ الإمامُ الرِّضا (عليه السلام): عَنْ عَيْشِ الدُّنْيا؟ فَقالَ: سِعَةُ الْمَنْزِلِ وَ كَثْرَةُ الْمحِبّينَ.

از حضرت امام رضا (عليه السلام) درباره خوشی دنیا سؤال شد. فرمود: وسعت منزل و زیادی دوستان.

26- Ndikimet e dëmshme të sundimtarëve shtypës

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Në kohën që sundimtarët gënjejnë, nuk do të bjerë shi; kur sundimtari shtyp, qeveria do të poshtërohet; kur nuk jepet zekati i pronave, bagëtia do të ngordhë".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): إذا كَذَبَ الْوُلاةُ حُبِسَ الْمَطَرُ، وَ إذا جارَ السُّلْطانُ هانَتِ الدَّوْلَةُ، وَ إذا حُبِسَتِ الزَّكوةُ ماتَتِ الْمَواشی.

زمانی که حاکمان دروغ بگویند باران نبارد، و چون زمامدار ستم ورزد، دولت، خوار گردد. و اگر زکات اموال داده نشود چهارپایان از بین روند.





27- Heqja e pikëllimit ndaj besimtarit

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Kush ia heq hidhërimin dhe telashet një besimtari, Allahu ia largon pikëllimin nga zemra e tij në Ditën e Gjykimit".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): مَنْ فَرَّجَ عَنْ مُؤْمِن فَرَّجَ اللهُ عَنْ قَلْبِهِ يَوْمَ القِيمَةِ.

هر کس اندوه و مشکلی را از مؤمنی برطرف نماید، خداوند در روز قیامت اندوه را از قلبش برطرف سازد.

28- Vepra më e mirë, pas veprave të detyruara *(vaxhib)*

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Pas kryerjes së detyrave, nuk ka vepër më të mirë tek Allahut, se sa të gëzosh një besimtar".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): لَيْسَ شَيْءٌ مِنَ الأَعْمالِ عِنْدَ اللهِ عَزَّوَجَلَّ بَعْدَ الْفَرائِضِ أَفْضَلَ مِنْ إِدْخالِ السُّرُورِ عَلَى الْمُؤْمِنِ.

بعد از انجام واجبات، کاری بهتر از ایجاد خوشحالی برای مؤمن، نزد خداوند بزرگ نیست.

29- Tri gjëra të lidhura me tri cilësi

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Tri gjëra varen nga tri cilësi:*

1- Vështirësitë ditore për dikë që ka mjete të shumta.

2- Sundimi i privimit për atë që është i prapambetur në industri.

3- Armiqësia e njerëzve të thjeshtë për njerëzit e dijes".

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): ثَلاثَةٌ مُوَكِّلٌ بِها ثَلاثَةٌ: تَحامُلُ الاَيّامِ عَلى ذَوِى الاَدَواتِ الْكامِلَةِ وَإِسْتيلاءُ الْحِرْمانِ عَلَى الْمُتَقَدِّمِ فى صَنْعَتِهِ، وَ مُعاداةُ الْعَوامِ عَلى أَهْلِ الْمَعْرِفَةِ ».

سه چیز وابسته به سه چیز است:

1. سختی روزگار بر کسی که ابزار کافی دارد،

2. محرومیت زیاد برای کسی که در صنعت عقب مانده باشد،

3. و دشمنیِ مردم عوام با اهل معرفت.

30- Modestia dhe bamirësia

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Ju këshilloj, që të jeni modest, si në varfëri, ashtu edhe në pasuri; të bëni mirë qoftë shumë, qoftë pak, sepse në Ditën e Gjykimit, Allahu i Plotfuqishëm do ta zmadhojë dhënien e një gjysmë hurme aq sa mali Uhud".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): عَلَيْكُمْ بِالْقَصْدِ فِي الْغِنى وَ الْفَقْرِ، وَ الْبِرِّ مِنَ الْقَليلِ وَ الْكَثيرِ فَإِنَّ اللهَ تَبارَكَ وَ تَعالى يَعْظُمُ شِقَّةَ التَّمْرَةِ حَتّى يَأْتِيَ يَوْمَ الْقِيمَةِ كَجَبَلِ أُحُد.

بر شما باد به میانه‌روی در فقر و ثروت، و نیکی کردن چه کم و چه زیاد، زیرا خداوند متعال در روز قیامت یك نصفه خرما را چنان بزرگ نماید که مانند کوه اُحد باشد.

31- Vizita dhe shprehja e miqësisë me njëri-tjetrin

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Vizitojeni njëri-tjetrin, duajeni njëri-tjetrin, shtrëngoni duart me njëri-tjetrin dhe mos mbani mëri me njëri-tjetrin".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): تَزاوَرُوا تَحابُّوا وَ تَصافَحُوا وَ لا تَحاشَمُو.

به دیدن یکدیگر روید تا یکدیگر را دوست داشته باشید و دست یکدیگر را بفشارید و به هم خشم نگیرید.

32- Mbuluesi i sekreteve në çështje të ndryshme

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Ruajini sekretet në çështjet tuaja, në fenë dhe dynjanë tuaj. Është transmetuar se zbulimi (i sekreteve) është mosbesim (mohim); se ai që zbulon sekretet, është ortak me vrasësin; se atë që fsheh prej armikut tënd, të mos e dijë as miku yt".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): عَلَيْكُمْ فى أُمُورِكُمْ بِالْكِتْمانِ فى أُمُورِ الدّينِ وَ الدُّنيا فَإِنَّهُ رُوِىَ « أَنَّ الإذاعَةَ كُفْرٌ» وَ رُوِىَ « الْمُذيعُ وَ الْقاتِلُ شَريكانِ» وَ رُوِىَ « ما تَكْتُمُهُ مِنْ عَدُوِّكَ فَلا يَقِفُ عَلَيْهِ وَلِيُّكَ».

بر شما باد به رازپوشی در کارهاتان در امور دین و دنیا. روایت شده که « افشاگری کفر است» و روایت شده « کسی که افشای اَسرار مکند با قاتل شریك است» و روایت شده که « هر چه از دشمن پنهان مداری، دوست توهم بر آن آگاهی نیابد».

33- Thyesi i besës dhe hileqarët

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Njeriu nuk mund të shpëtojë nga rrethi i të keqes duke thyer marrëveshjen dhe nuk ka shpëtim nga kthetrat e dënimit ai që mashtron të shtypurit".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): لا يَعْدُمُ المَرْءُ دائِرَةَ السَّوْءِ مَعَ نَكْثِ الصَّفَقَةِ، وَ لا يَعْدُمُ تَعْجيلُ الْعُقُوبَةِ مَعَ إِدْراءِ الْبَغْيِ.

آدمی نمیتواند از گردابهای گرفتاری با پیمان شکنی رهایی یابد، و از چنگال عقوبت رهایی ندارد کسی که با حیله به ستمگری می پردازد.

34- Përballja e përshtatshme me katër grupe

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Shoqëroku me mbretin dhe sundimtarin, me frikë dhe kujdes, me mikun me thjeshtësi, me armikun me kujdes dhe me masën e njerëzve, me fytyrë të qeshur".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): إِصْحَبِ السُّلْطانَ بِالْحَذَرِ، وَ الصَّديقَ بِالتَّواضُعِ، وَ الْعَدُوَّ بِالتَّحَرُّزِ وَ الْعامَّةَ بِالْبُشْرِ.

با سلطان و زمامدار با ترس و احتیاط همراهی کن، و با دوست با تواضع و با دشمن با احتیاط، و با مردم با روی خوش.

35- Kënaqësia me furnizimin e paktë

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Kush është i kënaqur me furnizim të paktë nga Allahu, Allahu është i kënaqur me punën e tij të paktë".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): مَنْ رَضِيَ عَنِ اللهِ تَعالى بِالْقَليلِ مِنَ الرِّزْقِ رَضِيَ اللهُ مِنْهُ بِالْقَليلِ مِنَ الْعَمَلِ.

هر کس به رزق و روزی کم از خدا راضی باشد، خداوند از عمل کم او راضی باشد.

36- Intelekti dhe sjellja

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Intelekti (el aklu) është dhuratë nga Allahu. Të jesh i sjellshëm, do të thotë të durosh vështirësi. Kush e mban edukatën me vështirësi, do të jetë sundues mbi të, por, kush është arrogant me intelektin, nuk fiton asgjë, përveç injorancës".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): أَلْعَقْلُ حِباءٌ مِنَ اللهِ، وَ الأَدَبُ كُلْفَةٌ فَمَنْ تَكَلَّفَ الأَدَبَ قَدَرَ عَلَيْهِ، وَ مَنْ تَكَلَّفَ الْعَقْلَ لَمْ يَزْدِدْ بِذلِكَ إِلاّ جَهْل ».

عقل، عطيّه و بخششی است از جانب خدا، و ادب داشتن، تحمّل يك مشقّت است، و هر كس با زحمت ادب را نگهدارد، قادر بر آن مشود، امّا هر كه به زحمت بخواهد عقل را به دست آورد جز بر جهل او افزوده نمشود.

37- Shpërblimi i të përpjekurve

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Në të vërtetë, ai që kërkon mirësi (risk) për të mbajtur familjen e tij, ka shpërblim më të madh se një luftëtar në Rrugën e Allahut".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): إِنَّ الَّذى يَطْلُبُ مِنْ فَضْل يَكُفُّ بِهِ عِيالَهُ أَعْظَمُ أَجْرًا مِنَ الْمجاهِدِ فى سَبيلِ اللهِ.

به راستی کسی که در پی افزایش رزق و روزی است تا با آن خانواده خود را اداره کند، پاداشش از مجاهد در راه خدا بیشتر است.

38- Mos shpresoni te pesë veta
(persona)

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Pesë gjëra që nuk janë te dikush, mos shpreso për asgjë tek ai as për këtë botë dhe as për Botën Tjetër (Ahiret):*

1- Tek ai që nuk e di prejardhjen e tij.

2- Tek ai që, në natyrën e tij, nuk gjen bujari.

3- Tek ai që nuk ka qëndrueshmëri në krijimin e tij.

4- Tek ai që nuk ka mirësjellje.

5- Tek ai që nuk ka frikë nga Zoti i tij".

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): خَمْسٌ مَنْ لَمْ تَكُنْ فيهِ فَلا تَرْجُوهُ لِشَيْء مِنَ الدُّنْيا وَ الْأخِرَةِ:مَنْ لَمْ تَعْرِفَ الْوَثاقَةَ فى أُرُومَتِهِ، وَ الكَرَمَ فى طِباعِهِ، وَ الرَّصانَةَ فى خَلْقِهِ، وَ النُّبْلَ فى نَفْسِهِ، وَ الَمخافَةَ لِرَبِّهِ ».

پنج چیز است که در هر کس نباشد امید چیزی از دنیا و آخرت به او نداشته باش:1.کسی که در نهادش اعتماد نبینی،2. و کسی که در سرشتش کَرم نیابی،3. و کسی که در آفرینشش استواری نبینی،4. و کسی که در نفسش نجابت نیابی،5. و کسی که از خدایش ترسناك نباشد.





39- Fitorja e faljes

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Kur dy grupe do të përballen me njëri-tjetrin, fitorja është me grupin që fal më shumë".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): مَا التَقَتْ فِئَتانِ قَطُّ إلاّ نُصِرَ أَعْظَمُهُما عَفْوً.

هرگز دو گروه با هم روبه رو نمشوند، مگر این که نصرت و پیروزی با گروهی است که عفو و بخشش بیشتری داشته باشد.

40- Veprat e mira dhe dashuria për familjen e Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*

Imam Rizai *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: *"Mos i braktis veprat e mira dhe adhurimin, duke u mbështetur vetëm te dashuria për familjen e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!). Mos e braktis dashurinë për familjen e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!), duke u mbështetur vetëm në adhurime, sepse asnjëra prej tyre nuk mund të pranohet pa tjetrën".*

قالَ الإمام الرضا (عليه السلام): لا تَدْعُوا الْعَمَلَ الصّالِحَ وَ الاِجْتِهادَ فِی الْعِبادَةِ إِتّکالاً عَلی حُبِّ آلِ مُحَمَّد (عليهم السلام) وَ لا تَدْعُوا حُبَّ آلِ مُحَمَّد (عليهم السلام) لاَمْرِهِمْ إِتّکالاً عَلَی الْعِبادَةِ فَإِنَّهُ لا یُقْبَلُ أَحَدُهُما دُونَ الاْخَرِ.

مبادا اعمال نیك را به اتّکای دوستی آل محمّد (علیهم السلام) رها کنید، و مبادا دوستی آل محمّد(علیهم السلام) را به اتّکای اعمال صالح از دست بدهید، زیرا هیچ کدام از این دو، به تنهایی پذیرفته نمشود.

ZIJARETI I IMAM ALI IBN MUSA RIZAIT

(Paqja qoftë mbi të!)

Është shkruar shumë për mirësinë e zijaretit të Imamit të njerëzve e të xhindeve, për Imamin tonë, Ali ibn Musa Riza *(Paqja qoftë mbi të dhe mbi baballarët e tij!)*, i cili është varrosur në tokën e Horasanit.

Në librin "*Tuhfetu Zair*" thuhet se Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Një pjesë e trupit tim do të varroset në tokën e Horasanit. Cilido besimtar që do ta vizitojë atë, Allahu do ta shpërblejë me Xhenet dhe trupit të tij do t'ia ndalojë zjarrin*".

Në një hadith tjetër, Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* ka thënë: "*Një pjesë e trupit tim do të varroset në tokën e Horasanit. Cilido i brengosur që e viziton, Allahu do t'ia largojë atij brengat. Cilido gjynahqar që e viziton, Allahu do t'ia falë atij gjynahet*".

Për sa i përket mënyrës së zijaretit të Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)*, dije se janë

përmendur disa zijarete për të. Më i njohur është zijareti i përcjellë në libra të konsiderueshëm, që i atribuohet shejkhut të madh, Muhamed ibn Hasan el Uelijdit, i cili është prej shehlerëve të Sadukut *(Allahu e mëshiroftë!)*.

Nga Mezar ibn Kauleuijeh duket se ai zijaret është transmetuar nga Imamët *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Sipas librit *"Men la jehdheruhul Fakijh"*, mënyra e këtij zijareti është: Kur dëshiron të vizitosh vendvarrimin e Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)* në Tus (Mashhad), merr gusël para se të dalësh nga shtëpia. Gjatë guslit thuaj: "O Allah! Më pastro mua dhe pastroje zemrën time.

Ma zgjero gjoksin dhe bëj që gjuha ime të të lavdërojë Ty, të shprehë dashurinë Tënde dhe të të falënderojë Ty! Fuqia nuk është veçse prej Teje! O Allah, bëje këtë gusël pastrim dhe shërim, për mua".

Kur të dalësh nga gushi, thuaj: "Bismilah, ue bilah ue ilallah ue ila ibn Resulilah". "Allahu është Sipërmarrësi im dhe Atij i mbështetem! O Allah! Për te Ti jam drejtuar dhe Ti je qëllimi im! Kërkoj prej Teje ato që Ti ke!"

Kur të dalësh nga shtëpia, qëndro te dera e shtëpisë dhe thuaj: "O Allah! Për te Ti jam drejtuar! Për Ty kam lënë pas familjen, pasurinë dhe gjithçka që më ke dhënë! Ty të besoj për gjithçka! Mos më

kthe duarbosh! O Ti që nuk e kthen duarbosh atë që të kërkon Ty, nuk e humbet atë që Ti e ruan, bekoje Profetin dhe familjen e Profetit! Më ruaj mua me ruajtjen Tënde! Vërtet, nuk humbet ai që Ti e ruan!"





ZIJARETI I IMAM ALI IBN MUSA RIZAIT

(Paqja qoftë mbi të!)

Ulu te ana e kokës së Imam Rizait *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe thuaj:

"Paqja qoftë mbi ty, o i dashuri i Allahut! - Es selamu alejke ja uelijjallah!

Paqja qoftë mbi ty, o argumenti i Allahut! - Es selamu alejke ja huxhxhetallah!

Paqja qoftë mbi ty, o dritë e Allahut, në errësirat e tokës! - Es selamu alejke ja nurallahu fi dhulumatil erdi!

Paqja qoftë mbi ty, o shtylla e fesë! - Es selamu alejke ja amude dijn!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Ademit, i zgjedhuri i Allahut! - Es selamu alejke ja uarithe Ademe safuatilah!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Nuhut, i Profetit të Allahut! - Es selamu alejke ja uarithe Nuhin nebijjilah

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Ibrahimit, mikut të Allahut! - Es selamu alejke ja uarithe Ibrahime khalililah!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Ismailit, kurbanit të Allahut! - Es selamu alejke ja uarithe Ismaile dhebijhilah

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Musait, folësi me Allahun! - Es selamu alejke ja uarithe Musa kelimilah!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëguesi i Isait, shpirti i Allahut! - Es selamu alejke ja uarithe Isa Ruhilah!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Muhamedit, i Dërguari i Allahut! - Es selamu alejke ja uarithe Muhamedin Resulilah!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i prijësit të besimtarëve, Imam Aliut, i

dashuri i Allahut dhe zëvendësi i të Dërguarit të Zotit të botëve! - Es selamu alejke ja uarithe emijrel mu'minine, Alijun uelijullah ue uasiji Resuli Rabil Alemijn!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Fatime Zehrasë! - Es selamu alejke ja uarithe Fatime Zahra!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Hasanit dhe Hysejnit, zotërinjtë e të rinjve të banorëve të Xhenetit! - Es selamu alejke ja uarithel Hasani uel Husejni sejjidej shebabi ehlil Xhenneh!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Aliut, i biri i Hysejnit, Zejnel Abidijnit! - Es selamu alejke ja uarithe Ali ibn Husejn, Zejnul Abidijn!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Muhamedit, i biri i Aliut, matësi dhe shpërthyesi i diturive të të parëve dhe të të fundmëve! - Es selamu alejke ja uarithe Muhamed ibn Ali, Bakiril ulumil euelijne uel akhirijne!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëgimtari i Xhaferrit, i biri i Muhamedit, i vërteti, i virtytshmi! - Es selamu alejke ja uarithe Xha'fer ibn Muhamed Es Sadiku El Barr'rru!

Paqja qoftë mbi ty, o trashëguesi i Musait, i biri i Xhaferrit! - Es selamu alejke ja uarithe Musa ibn Xha'fer!

Paqja qoftë mbi ty, o i vërtetë, o dëshmor! - Es selamu alejke ja ejjuhes sidijk esh shehijd!

Paqja qoftë mbi ty, o zëvendës i virtytshëm e i devotshëm! - Es selamu alejke ejjuhel uesijju el barr'rru et tekijju!

Dëshmoj se ti e fale namazin dhe zekatin, urdhërove në të mira, ndalove nga të këqijat dhe e adhurove Allahun, derisa të erdhi vdekja! - Eshhedu enneke kad ekamte salate ue atejte zekate ue emerte bil ma'rufi ue nehejte anil munkeri ue abedtellahe hatta etakel jekijn!

Paqja, mirësia dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ty, o babai i Hasanit! -

Es selamu alejke ja Aba Hasan ue rahmetullahi ue berekatuhu!"

Allahu na mbarësoftë, që të jemi në rrugën e eulijave të Tij, në këtë jetë dhe na bashkoftë me ata në Jetën Tjetër!





اسم الكتاب: اربعون حديث عن الإمام الرضا عليه السلام

ترجمة الأحاديث: اليسابتا فزا

تحت النظر: الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحيح الادبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كارای

الإخراج النهائي: صبريه فزا

الغلاف: صبريه فزا

الناشر: جمعيت نسيم

تيرانا: 2021